



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 10768 Prot.

Lezhë, më 02 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 163 Datë 02 . 12 . 2021

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 5 DATË 27.01.2021
PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TË PASTREHËVE QË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIM TË QIRASË PËR VITIN 2021”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë, për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lire nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

- I. Miratimin e një shtese në listën e familjeve të pastreha që do të trajtohen me pagesë të qirasë së banesave për vitin 2021, si në vijim:
 1. **E. B.** për vlerën 15 000 lekë në muaj.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

